REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4959/2 **prot.** **Gramsh, më** 16 / 11 /2026

RELACION

Mbi përfundimin e procesit të zgjedhjes së Kryesisë dhe Kryetarit në Fshatin Bicaj të Njësisë Administrative Lenie të Bashkisë Gramsh dhe afatin e nisjes për shpërblimin e tyre

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 70 pika 1,2,3,4,5 dhe neni 71 pika 1,2,3,4,5,6,7 dhe VKM Nr.103 datë 11.02.2026, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, date 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, 'Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njesive te vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve te pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore, të ndryshuar"; si dhe mbështetur në rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak Nr. 55 datë 24.10.2016 dhe Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 58 datë 28/07/2023 "Për zgjedhjen e kryesisë dhe kryetarëve të fshatrave në 9 njësitë administrative të Bashkisë Gramsh."

Paraqesim para jush, materialin me përfundimin e procesit të zgjedhjes së Kryesisë dhe Kryetarit në Fshatin Bicaj të Njësisë Administrative Lenie të Bashkisë Gramsh.
Shpërblimi i kryetarëve të fshatrave buron nga Ligji i Vetqeverisjes vendore Nr. 139 datë 17.12.2015 neni 51 pika1; 71 pika 6 si dhe VKM Nr.103 datë 11.02.2026.

Këshilli i Ministrave në zbatim të ligjit 139/2015 ka përcaktuar nivelet e pagave për funksionarët e zgjedhur nga organet përfaqsuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore.
Referuar nenit 71 të ligjit 139/2015 pika 6 "Kryetari i fshatit shpërblehet për punën që kryen, sipas kritereve të përcaktuara nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.'' Dhe kriteret ku mbështetet Këshilli Bashkiak janë përcaktuar në VKM Nr.103 datë 11.02.2026.

Këshilli Bashkiak ka përcaktuar me vendim numër 21 datë 27.03.2026 , "Për disa ndryshime në nivelin e pagave e shpërblimeve,të punonjësve e personave, të emëruar ose të zgjedhur të Bashkisë Gramsh,për vitin 2026 të Vendimit nr.86 datë 27.12.2024 "Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave e shpërblimeve,të punonjësve e personave, të emëruar ose të zgjedhur të Bashkisë Gramsh"

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
XHULIA GJINI

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshi" Bulevardi "10 Korriku", E-mail:bashkia.gramsh2017@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.4858/3 prot. **Gramsh, më 16 / 11 /2026**

P/VENDIM

Mbi përfundimin e procesit të zgjedhjes së Kryesisë dhe Kryetarit në Fshatin Bicaj të Njësisë Administrative Lenie të Bashkisë Gramsh dhe afatin e nisjes për shpërblimin e tyre.

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e radhës datë . .2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e përgatitur nga Sekretari i Këshillit Bashkiak dhe në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 70 pika 1,2,3,4,5 dhe neni 71 pika 1,2,3,4,5,6,7 dhe VKM Nr.103 datë 11.02.2026, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, date 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, 'Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njesive te vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve te pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore, të ndryshuar" si dhe mbështetur në rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak Nr. 55 datë 24.10.2016 dhe vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 58 datë 28/07/2023 "Për zgjedhjen e kryesisë dhe kryetarëve të fshatrave në 9 njësitë administrative të Bashkisë Gramsh."

Vendosi

1- Të miratojë zgjedhjen e Z.Çelnik Xhangoli ; Kryetari i ri i fshatit Bicaj,Njësia Administrative Lenie, sipas procesverbalit datë 02/11/2026 dhe hyrjen në fuqi të efekteve financiare nga muaji Nëntor 2026.

2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak, Administratori i Njësisë Lenie dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetësë dhe Financës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
Xhulia Gjini

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
Luljeta Dollani